

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria Financave dhe Ekonomisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	<ul style="list-style-type: none"> - Politika e Konkurrencës - Advokacia e Konkurrencës dhe Strategjia e Komunikimit - Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë nr. 322, datë 18.05.2022 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Për t’u plotësuar
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2023
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Denar Biba denar.biba@caa.gov.al 0422234504
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
<p>PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT</p> <p><i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij. Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?</i></p> <p>Ky projektligj buron nga akte të brendshme siç është Rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020, nëpërmjet të cilës Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka lënë për AK rekomandimin: “Brenda vitit 2021 të paraqesë në Kuvend për amendim ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar” dhe për vitin 2021: “Të përfshijë sa më parë ndryshimet për rishikimin e Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, në procesin e konsultimit publik, me qëllim paraqitjen e tyre në Kuvend brenda vitit 2022”.</p>	

Nevoja për të rishikuar kuadrin ligjor aktual të konkurrencës vjen nga praktika e Autoritetit të Konkurrencës, i cili duke mbajtur në konsideratë praktikën më të mirë të institucioneve homologe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ka luajtur ndër vite një rol kyç në mbikëqyrjen dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në të gjitha sektorët e ekonomisë në Shqipëri. Në këtë kuptim, është e nevojshme për të garantuar një rregullim ligjor më të qendrueshëm dhe efektiv, duke kontribuar në zhvillimin e një tregu më të hapur dhe më konkurrues, që ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” të reflektojë këtë përvojë të arritur.

Gjithashtu, në kuadrin e procesit të integritimit evropian, theksojmë detyrimin e Shqipërisë, në bazë të nenit 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian e Shteteve të tyre anëtarë (MSA), për të harmonizuar legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës me të drejtën komunitare (*acquis*) dhe për të krijuar një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e konkurrencës.

Ligji aktual për mbrojtjen e konkurrencës është gjerësisht i përfaruar me dispozitat e *acquis*, për sa i përket neneve 101 e 102 TFBE, si dhe parashikimet lidhur me procedurat e kontrollit të përqendrimeve.

Projektligji i propozuar, nuk është një ligj krejtësisht i ri për mbrojtjen e konkurrencës në Shqipëri, por përmirëson një pjesë të konsiderueshme të dispozitave të ligjit aktual në pjesën institucionale, pjesën procedurale dhe atë substanciale, ndërsa përfshin edhe dispozita të reja të cilat përafrojnë më tej *acquis* duke ndihmuar në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të MSA-së dhe duke çuar përpara procesin e integritimit evropian të vendit.

Ndërrhyrja e qeverisë vlerësohet e nevojshme pasi, bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se Këshilli i Ministrave ka të drejtën për të propozuar ligje dhe në bazë të nenit 82 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, propozimi i ligjeve, kur është rasti, duhet të shoqërohet kurdoherë me raportin që për ligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit:

Objektivat kryesorë të këtij propozimi janë:

- Harmonizimi me *acquis* të BE dhe zbatimi i standardeve të BE në fushën e mbrojtjes së konkurrencës, duke u përshtatur me sfidat e kohës dhe konceptet e reja në fushën e mbrojtjes së konkurrencës;
- Të sigurohet liria e veprimtarisë ekonomike për subjektet që operojnë në tregun e brendshëm;
- Mbrojtja e konkurrencës në mënyrë sa më efektive nëpërmjet forcimit të rolit të AK në cilësinë e autoritetit përgjegjës për garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg;

- Sigurimi i mbikëqyrjes efektive të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës nëpërmjet ndërveprimit me bazat e të dhënave të agjencive ligjzbatuese;
- Garantimi i një trajtimi më të mirë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të sekreteve tregtare lidhur me ndërmarrjet që ndjekin procedura në bazë të kuadrit ligjor të mbrojtjes së konkurrencës;
- Krijimi i një kuadri ligjor gjithëpërfshirës e të përditësuar, duke përfshirë në kompetencat e AK format e “marrëveshjeve në oferta” gjatë procedurave të prokurimit publik, “killer acquisitions” dhe “ftesë për marrëveshje të ndaluar”, në reflektim të eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit. Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

- Opsioni 0: Status Quo-ja (nënkupton vijimin me ligjin aktual) nuk është opsion i preferuar për shkak të nevojës që del për rishikimin e parashikimeve të ligjit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës, kjo në linjë edhe me praktikatat më të mira dhe modelit të BE-së.
- Opsioni 1 (jo rregullator): Marrja e masave jorregulatore, si vetërregullimi ose ndërgjegjësimi i organeve të vlerësimit dhe kryerjen e fushatave ndërgjegjësuese. Ky opsion nuk adreson siç duhet problemin
- Opsioni 2 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Duke mbajtur në konsideratë që ligji ekzistues, është gjerësisht i përafëruar me dispozitat e *acquis*, me nenet 101 dhe 102 TFBE, Rregulloren e Këshillit Evropian (KE) nr. 1/2003 e datës 16 Dhjetor 2002 lidhur me zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit si dhe me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 lidhur me kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve, vlerësohet që propozimet e projektligjit të implementohen përmes ndryshimeve në ligjin ekzistues.
- Opsioni 3: Miratimi i një ligji të ri. Ky nuk është një opsion i preferuar, duke qenë se ndryshimet prekin disa prej dispozitave të ligjit në fuqi e më e përshtatshme është ndërhyrja në ligjin ekzistues.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar. Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar shoqërohet me **ndikim ekonomik** për Buxhetin e Shtetit, pasi Autoriteti i Konkurrencës është organ publik i pavarur që financohet nga Buxheti i Shtetit.

Ndryshimet e parashikuara në ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, synojnë të kenë ndikim pozitiv në aspektin social, duke ndihmuar në garantimin e një mjedisi më të drejtë dhe më konkurrues për të gjithë aktorët e tregut në Shqipëri, si dhe në aspektin ekonomik, duke patur për qëllim nxitjen e efijencave ekonomike në tregun e brendshëm.

Ato reflektojnë praktikën e Autoritetit të Konkurrencës ndër vite, si dhe harmonizimin me *acquis* dhe praktikat më të mira të institucioneve homologe në Bashkimin Evropian, lidhur me: përmirësimin e qëllimit; përkufizimin e koncepteve “praktikë e bashkërenduar”, “marrëveshje në oferta”, “sekret tregtar”; ndalimin dhe sanksionimin e “ftesës për marrëveshje në oferta”; parashikimin e kontrollit mbi përqendrime të njohura si “killer acquisitions”; trajtimi i përmirësuar dhe më gjithëpërfshirës i dispozitave lidhur me “konfliktin e interesit” si dhe “ruajtjen e konfidencialitetit dhe sekreteve tregtare”; ofrimin e sigurisë juridike lidhur me afatet e parashkrimit për vendosjen e gjobave dhe për ekzekutimin e gjobave; etj.

Projektligji gjithashtu parashikon se të ardhurat që krijohen nga Autoriteti i Konkurrencës nga procedurat e kontrollit të përqendrimeve, tarifave administrative për kontrollin e përqendrimeve dhe autorizimet e përqendrimeve, si dhe të ardhurat që krijohen nga procedurat e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve do të përdoren nga ana e Autoritetit për qëllime investimi dhe shpenzime operative, të cilat kontribuojnë në përmbushjen e misionit të tij. Të ardhurat në fjalë do të përdoren sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës.

Për Autoritetin e Konkurrencës, kjo nismë do të kontribuojë që ky institucion të përmirësojë aftësitë dhe të zbatojë me efikasitet të lartë detyrat e tij lidhur me mbikëqyrjen dhe ndalimin e praktikave anti-konkurrese, në funksion të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe në tregun shqiptar.

Për më tepër, në kuadër të përmirësimit të efikasitetit të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës dhe realizimit të procedurave hetimore brenda afateve të përcaktuara në ligj, projektligji parashikon ngritjen e “Sistemit të Menaxhimit të Informacionit i Autoritetit të Konkurrencës” i cili do të ndërveprojë me bazat e të dhënave të institucioneve si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Qendra Kombëtare e Biznesit, dhe Agjencia e Prokurimit Publik.

Për konsumatorët, ndryshimet parashikojnë një rritje të nivelit të mbrojtjes së tyre kundër praktikave anti-konkurrese që kanë potencialin për të ndikuar në çmime dhe në cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, duke ndikuar në përmirësimin e jetesës së tyre. Gjithashtu, rregullimi i kontrollit mbi përqendrimet ‘killer acquisitions’, do të ndikojë pozitivisht në ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe përparimin e inovacionit duke i mundësuar konsumatorëve të kenë akses në produkte dhe shërbime të avancuara me çmime më të favorshme.

Për ndërmarrjet, veçanërisht ato të vogla dhe të mesme, ndryshimet ofrojnë siguri juridike dhe ndikojnë në krijimin e një mjedisi më të drejtë dhe më konkurrues, i cili rrit mundësitë për zhvillimin dhe zgjerimin e tyre. Në projektligj garantohet gjithashtu një trajtim më i mirë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të sekreteve tregtare lidhur me ndërmarrjet që ndjekin procedura në bazë të kuadrit ligjor të mbrojtjes së konkurrencës, duke ofruar më shumë siguri dhe mbrojtje për inovacionet dhe punën e tyre.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimën me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është Opsioni 2, pra ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ligji aktual për mbrojtjen e konkurrencës është gjerësisht i përfaruar me dispozitat e *acquis*, për sa i përket neneve 101 e 102 TFBE, si dhe parashikimet lidhur me procedurat e kontrollit të përqendrimeve. Projektligji i propozuar përmirëson një pjesë të konsiderueshme të dispozitave të ligjit aktual në pjesën institucionale, pjesën procedurale dhe atë substanciale, ndërsa përfshin edhe dispozita të reja të cilat përafrojnë më tej *acquis* duke ndihmuar në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të MSA-së dhe duke çuar përpara procesin e integritimit evropian të vendit.

Për këtë arsye, vlerësohet me e përshtatshme që të mos miratohet një ligj krejtësisht i ri për mbrojtjen e konkurrencës në Shqipëri, por propozimet e projektligjit të implementohen përmes ndryshimeve në ligjin ekzistues.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3	
23,5 milionë ¹	23,5 milionë	23,5 milionë	

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse)

Projektligji është hartuar me kontributin e Autoritetit të Konkurrencës, në bashkëpunim më Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në kuadër të promovimit të kulturës së konkurrencës, mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive dhe përafrimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor me *acquis* të Bashkimit Evropian, Autoriteti i Konkurrencës zhvilloi më datë 12 dhjetor 2022, aktivitetin me temë “Dita e Konkurrencës dhe prezantimi i ndryshimeve të propozuara në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

¹ Kjo vlerë përfaqëson mesataren e te ardhurave nga procedurat e kontrollit të përqendrimeve për periudhën 2021-2023

Autoritetit i Konkurrencës prezantoi ndryshimet ligjore në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndryshime të cilat kanë qenë pjesë e diskutimeve edhe në aktivitete të tjera të ngjashme ku aktorë të ndryshëm kanë patur mundësinë të shprehen në lidhje me to.

Projektligji, Raporti Vlerësimit të Ndikimit dhe Relacioni Shpjegues janë konsultuar gjerësisht me institucionet shtetërore dhe grupet e interesit, si dhe do të publikohen në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit.

Si rrjedhojë e konsultimit me institucionet shtetërore, Ministria e Drejtësisë, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, paraqitën sugjerimet e tyre lidhur me projektligjin, sugjerime të cilat u reflektuan në ndryshimet e projektligjit në pjesën më të madhe të tyre.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohet zbatimi dhe monitorimi

Autoriteti i Konkurrencës do të jetë institucioni përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e ndryshimeve ligjore të propozuara në projektligj, si organ publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të tij në bazë të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, qëllimi i të cilit është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si një e mirë publike.

Për këtë qëllim, Autoriteti do të ndërmarrë disa masa që konsistojnë në:

- përgatitjen e akteve nënligjore përkatëse mbi kriteret dhe procedurat për zbatimin e ndryshimeve ligjore
- monitorimin dhe inspektimin e ndërmarrjeve për të zbuluar dhe parandaluar praktikant antikonkurrese
- këshillimi me ndërmarrjet mbi zbatimin e kuadrit ligjor mbi mbrojtjen e konkurrencës
- ndjekja e procedurave hetimore dhe, kur është e nevojshme, sanksionimi me gjobavë dhe masa të tjera të aplikueshme
- raportimi dhe transparenca lidhur me veprimtarinë e Autoritetit, duke siguruar që aktivitetet dhe vendimet e tij të jenë të njohura publikisht.
- bashkëpunimi me organet e administratës qendrore dhe vendore për monitorimin e zbatimit të ndryshimeve ligjore.

Përmes këtyre masave, Autoriteti i Konkurrencës do të sigurojë se ndryshimet e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës do të aplikohen në mënyrë efektive.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

□ *Jepni kontekstin e politikës*

Më datë 28.07.2003, u miratua Ligji Nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës” i cili parashikoi ngritjen e institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, si institucioni publik i pavarur që garanton zbatimin e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e konkurrencës. Ligji i ri shfuqizoi Ligjin Nr. 8044, datë 07.12.1995 “Për konkurrencën”.

Më datë 27.07.2006, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 9590 për “Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian e Shteteve të tyre anëtarë”. Sipas nenit 71 të kësaj Marrëveshje, Shqipëria do të harmonizojë legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës me të drejtën komunitare. Bazuar në këtë dispozitë, Shqipëria gjithashtu do të krijonte një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e konkurrencës.

Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, u pasua me disa ndryshime me Ligjin Nr. 9499, datë 03. 04. 2006 “Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, dhe Ligjin Nr. 10 317 datë 16.09.2010 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të Ndryshuar”.

Në vitet në vijim, Autoriteti i Konkurrencës ka harmonizuar legjislacionin dytësor për mbrojtjen e konkurrencës me *acquis* në këtë fushë, nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ligji Nr. 9121/2003 është gjerësisht i përfaruar me dispozitat e *acquis* dhe me MSA, nenet 101 e 102 TFBE, si dhe parashikimet lidhur me procedurat e kontrollit të përqendrimeve. Ligji Nr. 9121/2003 ("Ligji") kryesisht përputhet me dispozitat thelbësore të synuara nga Direktiva ECN+ 2019/01 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 Dhjetor 2018 për të fuqizuar autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare të jenë zbatues më efektivë dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut të brendshëm ("Direktiva ECN +").

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Nevoja për të rishikuar kuadrin ligjor aktual të konkurrencës vjen nga praktika e Autoritetit të Konkurrencës, i cili duke mbajtur në konsideratë praktikatat më të mira të institucioneve homologe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ka luajtur ndër vite një rol kyç në mbikëqyrjen dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në të gjitha sektorët e ekonomisë në Shqipëri. Në këtë kuptim, është e nevojshme që për të garantuar një rregullim ligjor më të qendrueshëm dhe efektiv, i cili do të ndihmojë Autoritetin e Konkurrencës në

përmbushjen e qëllimit të tij, që ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” të reflektojë këtë përvojë të arritur.

Zhvillimi i një tregu të hapur dhe konkurrues është i rëndësishëm për të gjithë shoqërinë në Shqipëri, efektet pozitive të të cilit ndihen drejtpërdrejt nga ndërmarrjet dhe në fund nga konsumatorët. Për bizneset e vogla dhe të mesme, rriten mundësitë për zhvillimin dhe zgjerimin e tyre. Për konsumatorët, një mbrojtje më e lartë kundër praktikave antikonkurruese ndikon në uljen e çmimeve, rritjen e cilësisë dhe përparimin e inovacionit në mallrat dhe shërbimet që u ofrohen.

Ligji aktual për mbrojtjen e konkurrencës është gjerësisht i përfaruar me dispozitat e *acquis*, për sa i përket neneve 101 e 102 TFBE, si dhe parashikimet lidhur me procedurat e kontrollit të përqendrimeve. Ky harmonizim ka ndodhur në kuadër të procesit të integritimit evropian, ku në bazë të nenit 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian e Shteteve të tyre anëtarë (MSA), vendi ynë ka për detyrim të harmonizojë legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës me të drejtën komunitare (*acquis*) dhe të krijojë një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e konkurrencës.

Për sa më sipër, vlerësohet se nuk është e nevojshme të hartohet një ligj krejtësisht i ri për mbrojtjen e konkurrencës në Shqipëri, por të përmirësohet ligji ekzistues me anë të ndryshimeve të propozuara në projektligj në pjesën institucionale, procedurale dhe substanciale, si dhe të përfshihen dispozita të reja të cilat përafrojnë më tej *acquis* duke ndihmuar në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të MSA-së dhe duke çuar përpara procesin e integritimit evropian të vendit.

Autoriteti i Konkurrencës do të jetë institucioni përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e ndryshimeve ligjore të propozuara në projektligj, ndryshime të cilat ngarkojnë dhe ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në Republikën e Shqipërisë me detyrimin ligjor për ti respektuar dhe zbatuar ato.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj nisme është të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes së konkurrencës dhe promovimin e një tregu më të hapur dhe më konkurrues në Shqipëri.

Konkurrenca e lirë dhe efektive është e rëndësishme për rritjen ekonomike, pasi inkurajon inovacionin, zvogëlon çmimet dhe përmirëson cilësinë e produkteve dhe shërbimeve. Ajo ka një ndikim pozitiv jo vetëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe sektorin e biznesit në tërësi, por edhe në jetën e përditshme të qytetarëve. Për këtë arsye, qeveria synon të ndryshojë kuadrin ligjor të konkurrencës për të garantuar një mjedis më të drejtë dhe më të konkurrues për të gjithë aktorët e tregut.

Arsye të tjera për ndërhyrjen e qeverisë përmes këtij projektligji lidhen me detyrimet e Shqipërisë për harmonizim me të drejtën komunitare të Bashkimit Evropian dhe për forcimin e rolit të Autoritetit të Konkurrencës si një institucion i pavarur dhe funksional në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës. Ky është një hap i rëndësishëm në procesin e integritimit evropian të vendit, duke siguruar se Shqipëria do të plotësojë kriteret dhe standardet e nevojshme të konkurrencës për të qenë një vend anëtar në Bashkimin Evropian.

Në lidhje me shkallën e ndërhyrjes së qeverisë, projektligji parashikon një rishikim të përgjithshëm të ligjit aktual për mbrojtjen e konkurrencës, duke përmirëuar një pjesë të konsiderueshme të dispozitave të ligjit aktual në aspektin institucional, procedural dhe substantial, ndërsa përfshin edhe dispozita të reja të cilat përafrojnë më tej *acquis*. Ky ndërhyrje konsiston në përmirësimin e qëllimit; përkufizimin e koncepteve “praktikë e bashkërenduar”, “marrëveshje në oferta”, “sekret tregtar”; ndalimin dhe sanksionimin e “ftesës për marrëveshje në oferta”; parashikimin e kontrollit mbi përqendrime të njohura si “killer acquisitions”; trajtimi i përmirësuar dhe më gjithëpërfshirës i dispozitave lidhur me “konfliktin e interesit” si dhe “ruajtjen e konfidencialitetit dhe sekreteve tregtare”; ofrimin e sigurisë juridike lidhur me afatet e parashkrimit për vendosjen e gjobave dhe për ekzekutimin e gjobave, krijimin e një sistemi të menaxhimit të informacionit i cili do të ndërveprojë me bazat e të dhënave të agjencive ligjzbatuese; etj.

Ky projektligj gjithashtu mbështet objektivat e nivelit të lartë të qeverisë për të promovuar zhvillimin ekonomik, rritjen e efikasitetit ekonomik në tregun e brendshëm dhe integrimin evropian të vendit. Në këtë kontekst, ndërhyrja është e përshtatshme dhe e nevojshme për të arritur këto qëllime të rëndësishme.

Për sa i përket punës ekzistuese, Autoriteti i Konkurrencës ka punuar vazhdimisht në drejtim të harmonizimit të legjislacionit dytësor me *acquis* në fushën e konkurrencës, duke miratuar aktet nënligjore dhe politikat e nevojshme.

Hartimi i këtij projektligj është në përputhje dhe me Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020, nëpërmjet të cilës Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka lënë për AK rekomandimin: “Brenda vitit 2021 të paraqesë në Kuvend për amendim ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar” dhe për vitin 2021: “Të përfshijë sa më parë ndryshimet për rishikimin e Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, në procesin e konsultimit publik, me qëllim paraqitjen e tyre në Kuvend brenda vitit 2022”.

Në këtë kuptim, ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme pasi, bazuar në nenin 81 dhe 82 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se Këshilli i Ministrave ka të drejtën për të propozuar ligje, propozimi i cili, kur është rasti, duhet të shoqërohet kurdoherë me raportin që për ligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifikë, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- Harmonizimi me *acquis* të BE dhe zbatimi i standardeve të BE në fushën e mbrojtjes së konkurrencës, duke u përshtatur me sfidat e kohës dhe konceptet e reja në fushën e mbrojtjes së konkurrencës;
- Të sigurohet liria e veprimtarisë ekonomike për subjektet që operojnë në tregun e brendshëm;
- Mbrojtja e konkurrencës në mënyrë sa më efektive nëpërmjet forcimit të rolit të AK në cilësinë e autoritetit përgjegjës për garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg;
- Sigurimi i mbikëqyrjes efektive të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës nëpërmjet ndërveprimit me bazat e të dhënave të agjencive ligjzbatuese;
- Garantimi i një trajtimi më të mirë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të sekreteve tregtare lidhur me ndërmarrjet që ndjekin procedura në bazë të kuadrit ligjor të mbrojtjes së konkurrencës;
- Krijimi i një kuadri ligjor gjithëpërfshirës e e të përditësuar, duke përfshirë në kompetencat e AK format e “marrëveshjeve në oferta” gjatë procedurave të prokurimit publik, “killer acquisitions” dhe “ftesë për marrëveshje të ndaluar”, në reflektim të eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
 - *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
 - *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*
- Opsioni 0: Status Quo-ja (nënkupton vijimin me ligjin aktual) nuk është opsion i preferuar për shkak të nevojës që del për rishikimin e parashikimeve të ligjit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës, kjo në linjë edhe me praktikatat më të mira dhe modelit të BE-së.
- Opsioni 1 (jo rregullator): Marrja e masave jorregulatore, si vetërregullimi ose ndërgjegjësimi i organeve të vlerësimit dhe kryerjen e fushatave ndërgjegjësuere. Ky opsion nuk adreson siç duhet problemin
- Opsioni 2 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Duke mbajtur në konsideratë që ligji ekzistues, është gjerësisht i përafëruar me dispozitat e *acquis*, me nenet 101 dhe 102 TFBE, Rregulloren e Këshillit Evropian (KE) nr. 1/2003 e datës 16 Dhjetor 2002 lidhur me zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit si dhe me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 lidhur me kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve, vlerësohet që propozimet e projektligjit të implementohen përmes ndryshimeve në ligjin ekzistues.
- Opsioni 3: Miratimi i një ligji të ri. Ky nuk është një opsion i preferuar, duke qenë se ndryshimet prekin disa prej dispozitave të ligjit në fuqi e më e përshtatshme është ndërhyrja në ligjin ekzistues.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

□ *Identifikoni se kush preket.*

- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni). ○ Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbliidhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës sjell efekte të rëndësishme sociale dhe ekonomike, për grupe të shoqërisë të cilët preken në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Grupet që preken në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ndryshimet ligjore të propozuara janë ndërmarrjet, të cilat janë të detyruara të zbatojnë rregullat e reja të konkurrencës, duke ndikuar në veprimarinë, marrëveshjet, dhe përgjegjësitë e tyre ligjore. Kjo do të ketë një ndikim ekonomik në uljen e çmimeve dhe rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, si dhe në inkurajimin e inovacionit. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndryshimet ligjore synojnë të inkurajojnë një mjedis më konkurrues dhe mundësitë e hyrjes në treg, duke stimuluar inovacionin dhe zgjerimin e aktivitetit të tyre. Për më tepër, do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e sektorëve të rinj ekonomikë dhe në rritjen e besimit të publikut në konkurrencën e lirë.

Nga ana tjetër, grupet që preken në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë nga ndryshimet ligjore të propozuara janë konsumatorët. Këto ndryshime lidhen me produktivitetin e tregut, përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, si dhe uljen e kostove të jetesës së tyre, duke ofruar më shumë mundësi zgjedhjesh dhe një mjedis më të besueshëm dhe transparent për blerjet dhe shërbimet e tyre.

Si përfundim, ndryshimet ligjore të propozuara synojnë të ndihmojnë në krijimin e një tregu më konkurrues. Në aspektin ekonomik, ndikojnë pozitivisht në rritjen e konkurrencës, inkurajimin e inovacionin dhe uljen e kostot për konsumatorët. Në aspektin shoqëror, ndikojnë në rritjen e besimit publik në konkurrencën e lirë dhe efektive, si dhe promovimin e një mjedis më të drejtë dhe transparent në treg. Kjo ndihmon në tërheqjen e investimeve, përmirësimin e performancës ekonomike dhe cilësinë e jetesës në shoqëri.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Projektligji i propozuar, nuk është një ligj krejtësisht i ri për mbrojtjen e konkurrencës në Shqipëri, por prezanton për herë të parë disa mekanizma të rinj dhe përmirëson një pjesë të konsiderueshme të dispozitave të ligjit aktual në aspektin institucional, procedural dhe substantial nisur nga praktika ndër vite e Autoritetit të Konkurrencës. Gjithashtu, në kuadër të procesit të integritimit evropian, parashikon dispozita të reja me qëllim harmonizimin e mëtejshëm me *acquis* dhe me praktikat më të mira të vendeve të BE-së.

Duke mbajtur në konsideratë që ligji ekzistues, është gjerësisht i përafëruar me dispozitat e *acquis*, përkatësisht me nenet 101 dhe 102 TFBE, Rregulloren e Këshillit Evropian (KE) nr. 1/2003 e datës 16 Dhjetor 2002 lidhur me zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit, si dhe me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 lidhur me kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve, vlerësohet më e përshtatshme që të mos miratohet një ligj krejtësisht i ri për mbrojtjen e konkurrencës në Shqipëri, por propozimet e projektligjit të implementohen përmes ndryshimeve në ligjin ekzistues.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Autoriteti i Konkurrencës, si institucioni përgjegjës për zbatimin e ndryshimeve të parashikuara në këtë projektligj, do të ndërmarrë masa në funksion të përmbushjes së qëllimit të tij si në vijim:

- **Përgatitja e akteve nënligjore** për rregullimin e kritereve dhe procedurave për zbatimin e ndryshimeve ligjore.
Konkretisht, projektligji parashikon se të ardhurat që krijohen nga Autoriteti i Konkurrencës nga procedurat e kontrollit të përqendrimeve, tarifave administrative për kontrollin e përqendrimeve dhe autorizimet e përqendrimeve, si dhe të ardhurat që krijohen nga procedurat e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve do të përdoren nga ana e Autoritetit për qëllime investimi dhe shpenzime operative, dhe do të përdoren sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës.
Gjithashtu, projektligji parashikon krijimin e “Sistemit të Menaxhimit të Informacionit i Autoritetit të Konkurrencës”, procedurat e ndërveprimit të të cilit, me bazat e të dhënave të insitucioneve si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Qendra Kombëtare e Biznesit, dhe Agjencia e Prokurimit Publik, do të përcaktohen në rregulloren “Për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit i Autoritetit të Konkurrencës”.
- **Rritja e kapaciteteve profesionale dhe teknike** të Autoritetit të Konkurrencës për zbatimin e dispozitave të reja të ligjit.
- **Këshillimi ndaj ndërmarrjeve** për të siguruar zbatimin e kuadrit ligjor mbi mbrojtjen e konkurrencës.
Për këtë qëllim, Autoriteti i Konkurrencës do të zhvillojë tryeza të rrumbullakëta me grupet e interesit në kuadër të advokacisë së konkurrencës.

Këto masa synojnë të sigurojnë një zbatim të ndryshimeve ligjore të propozuara në mënyrë efikase dhe të ndihmojnë në promovimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në tregun e Shqipërisë.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Autoriteti i Konkurrencës, si institucioni përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të ndryshimeve të parashikuara në këtë projektligj, do të ndërmarri masa në funksion të përmbushjes së qëllimit të tij si në vijim:

- **Monitorimi dhe inspektimi i ndërmarrjeve** për të zbuluar dhe parandaluar praktikant antikonkurrese.
Përmes renditjes së shkeljeve të zbuluara, treguesi për monitorimin e ndërmarrjeve do tregojë nivelin e respektimit të rregullave të konkurrencës dhe ndihmën e ofruar nga Autoriteti në parandalimin e praktikave antikonkurrese.

- **Ndjekja e procedurave hetimore dhe sanksionimi**, në raste të nevojshme, me gjobë dhe masa të tjera të përcaktuara në ligj.
Përdorimi i sanksioneve, si gjobat dhe masat tjera të parashikuara në ligj, do të konsiderohen tregues për efikasitetin e Autoritetit në zbatimin dhe mbrojtjen e konkurrencës.
- **Kontrolli i përqendrimeve**, përfshirë përqendrimet e njohura si "*killer acquisitions*", të cilat rregullohen për herë të parë me ndryshimet e prezantuara në projektligj.
Monitorimi i këtyre përqendrimeve do të tregojë se si ndryshimet e projektligjit kanë ndikuar në rregullimin e këtyre transaksioneve dhe në sigurimin e një konkurrence më të lirë.
- **Raportimi dhe transparenca** e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për të siguruar që vendimet dhe aktivitetet e tij janë të njohura publikisht.
Përditësimet periodike të informacionit të publikuar do të ndihmojnë të vlerësohet se në çfarë masë është i njohur angazhimi i institucionit për zbatimin e ndryshimeve ligjore.
- **Bashkëpunimi i ngushtë me organet e administratës qendrore dhe vendore** për të siguruar zbatimin e ndryshimeve ligjore në mënyrë koordinuar dhe efektive.
Niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit me këto institucione do të tregojë se sa efikas është zbatimi i ndryshimeve ligjore në të gjithë vendin.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Vit i 9	V iti 1 0
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5
Kosto për biznesin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për biznesin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Kosto për grupet e tjera – një herë		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto në total		23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5	23,5
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës											
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim											
Përfitimi për biznesin – një herë											
Përfitimi për biznesin – në vazhdim											
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë											
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim											
Kosto për buxhetin – në vazhdim											
Përfitimi në total											
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës											
Vlera aktuale e kostos në total		23,5									
Vlera aktuale e përfitimit në total											
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total		23,5									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2	23,5		23,5
Opsioni 3			